

POLICY BRIEF

Plani Sektorial për Turizmin 2026: Zbatueshmëria reale dhe Reforma DAC7

Analizë e pavarur e fizibilitetit të planit tatimor të turizmit – fokus te hendeku fiskal, informaliteti STR dhe kushtet për sukses.

ALTAX Think Tank · Maj 2026 · Tiranë, Shqipëri · altax.al

68/100

Indeksi Parafizibilitetit Real

45–65 mln €

Hendek Fiskal Vjetor 2026

65–75%

STR jashtë sistemit formal

ÇËSHTJA POLITIKE

Shqipëria po humb çdo vit 45–65 milionë euro të ardhura fiskale nga sektori i turizmit, kryesisht nga short-term rentals (STR) që operojnë nëpër platforma dixhitale si *Airbnb dhe Booking.com*. Pavarësisht planeve sektoriale vjetore, 65–75% e stokut STR kombëtar mbetet jashtë sistemit tatimor, duke krijuar një hendek strukturor dhe në rritje.

Plani Sektorial i Administratës Tatimore për Turizmin 2026 paraqet avancime të rëndësishme konceptuale dhe digjitale. Megjithatë, Indeksi i Parafizibilitetit Real mbetet në 68/100, identik me vitin 2025, gjë që konfirmon se problemi nuk është planifikimi, por transformimi i sistemit.

GJETJET KRYESORE

Çfarë funksionon?

- › Objektiva më të qarta dhe matshme të lidhura me Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave.
- › Integrim i teknologjisë AI dhe burimeve alternative të të dhënave.
- › Targetim më i gjerë (STR, turizëm alternativ, platforma dixhitale).
- › Indikatorë KPI mujor dhe sisteme monitorimi të përmirësuara.

Çfarë nuk funksionon?

- › Kapacitete institucionale të dobëta në terren, veçanërisht bregdeti gjatë sezonit.
- › Koordinim formal, jo operacional midis AT, bashkive, MTM dhe AKB-së.
- › Integrimi me platformat mbetet vullnetar, pa detyrim ligjor.
- › Kontrolli manual nuk mund të mbulojë mijëra njësi STR të shpërndarë.

▀ Paradoksi kryesor

Cilësia e dokumentit të planit ka evoluar (82/100), por kapaciteti real i zbatimit dhe hendeku fiskal janë rritur njëkohësisht. Kjo konfirmon se ndryshimi i nevojshëm është sistemik, jo procedural.

HENDEKU FISKAL – PANORAMA 2026

Humbja fiskale totale e turizmit për 2026 parashikohet të arrijë 45–65 milionë euro, me short-term rentals si kontribuues kryesor:

Burimi	Humbja 2025	Humbja 2026	Pesha	Vështirësia
Short-term Rentals (STR)	20–30 mln €	25–38 mln €	55–60%	Shumë e lartë
Restorante & Bare	8–15 mln €	9–16 mln €	20–25%	E lartë
Shërbime turistike	7–12 mln €	8–13 mln €	15–20%	E lartë
TOTAL	40–60 mln €	45–65 mln €	100%	–

Bregdeti mbetet epiqendra e hendekut fiskal – 22–38 mln € humbje vjetore, me vetëm 35–45% formalizim STR. Zona urbane (Tiranë) kanë formalizim dukshëm më të lartë (55–70%), duke e bërë pilot-in dixhital atje model të replikueshëm.

TRI SFIDA STRUKTURORE

<p>① Kapacitete Institucionale</p> <p>Staf i pamjaftueshëm gjatë sezonit kulmor (4 muaj). Bashkitë bregdetare pa kapacitet real monitorimi. Koordinim AT–Bashki kryesisht formal.</p>	<p>② Informaliteti Kompleks STR</p> <p>65–75% e stokut STR operon cash + platforma jashtë sistemit. Rezistencë e lartë sezonale. Mikro-operatorët privat të pa kapshëm me metodat aktuale.</p>	<p>③ Integrimi i Platformave</p> <p>Airbnb dhe Booking.com raportojnë vetëm vullnetarisht. Pa detyrim ligjor (DAC7), zbulimi mbetet fragmentar dhe i paefektshëm.</p>
--	---	--

REKOMANDIME POLITIKE – PRIORITET

ALTAX ofron gjashtë rekomandime të prioritetizuara sipas impaktit. Rekomandimi Nr. 1 është kusht paraprak për efektivitetin e të gjitha masave të tjera.

#	Masa Politike	Afati	Impakt Fiskal	Kosto
1	Transpozim i menjëhershëm i Fazës I DAC7 – raportim detyrueshëm nga platformat	Q3 2026	+18–25 mln €	Shumë e ulët
2	Task Force Kombëtare Bregdetare – AT + Bashki + MTM, staf sezonal i dedikuar	Q2 2026	Mbulim +40%	Mesatare
3	Pilot dixhital i integruar Vlorë – Durrës – Sarandë (sezoni 2026)	Sez. 2026	Testim real	Mesatare
4	Regjistër Kombëtar STR + Paketë Incentivash + amnisti fiskale vullnetare	Q2 2026	Ulje rezistence	E ulët
5	Rekrutim 80–100 inspektorë sezonalë + trajnim specifik AI dhe platforma	Para sez.	Kapacitet +	Mesatare
6	Platformë e vetme integruese të dhënash DPT–Bashki–Platforma	2026–2027	Kohë reale	E lartë

Masat 2–6 kanë efektivitet të kufizuar pa Masën 1. DAC7 Faza I është kushti sine qua non, pasi ajo eliminon nevojën e kontrollit manual dhe mbyll boshllëkun informativ strukturor të sektorit STR.

SKENARË – ME DHE PA REFORMËN DAC7

Indikator	Pa DAC7 (Status Quo)	Me DAC7 Faza I
Mbyllje hendekut fiskal	25–35%	40–55%
Të ardhura shtesë (proj.)	10–15 mln €	18–30 mln €
STR të formalizuar (%)	30–40%	55–70%
Kosto administrative	E lartë (manual)	E ulët (automatik)
Vlerësim Fizibiliteti Real	68/100	78–82/100

KONKLuzion

Plani Sektorial i Turizmit 2026 ka cilësi të lartë konceptuale, por fizibiliteti real mbetet mesatar. Kërkohe zbatim i reformës strukturore, sidomos transpozimin e DAC7.

Buxheti i Shtetit rrezikon të humbasë çdo vit dhjetëra milionë euro të ardhura tatimore nga sektori me rritje më të shpejtë.

Mesazhi thelbësor ALTAX

*Suksesi i Planit 2026 nuk varet nga numri i kontrolleve në terren,
por nga kalimi nga sistemi manual në sistem automatik digjital.*

**DAC7 Faza I duhet të jetë shtyllë qendrore operationale e Planit 2026,
jo masë plotësuese.**

BURIMET

- › Plani Sektorial i Administratës Tatimore për Turizmin 2026 – Departamenti i Politikave Tatimore (DPT).
- › Raport i Fizibilitetit ALTAX 2025 – Analizë e Planit Sektorial të mëparshëm.
- › AirDNA Market Data 2025–2026 | INSTAT – Statistikat e Turizmit | Booking.com Market Intelligence.
- › Strategjia Afatmesme e të Ardhurave 2024–2027 – Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- › Direktiva DAC7 e Bashkimit Europian (2021/514) – Raportimi automatik i të dhënave nga platformat dixhitale.

–POLICY BRIEF–

ALTAX · Qendra e Kërkimeve Fiskale dhe Ekonomike · Tiranë, Maj 2026 · altax.al